REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA POGRADEC**

**KESHILLI**

Nr. 214/1 prot.

Pogradec, më 30.01.2023

# VENDIM

**Nr. 13, DATË 26/01/2023**

**PËR**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS TË SIPËRFAQES SË TOKËS PREJ 48,8290 HA, E NDODHUR NË NJËSITË ADMINISTRATIVE PROPTISHT, ÇËRRAVË, VELÇAN, BUÇIMAS, QË MUND TË JEPEN ME QIRA.**

Në mbështetje të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015 "Per Vetëqeverisjen Vendore" , neni 2 i ligjit nr. 8312, datë 26.03.1998 "Për tokat bujqësore të pandara", Udhëzimin nr. 1, datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara" dhe Udhëzimit nr.2, datë 20.04.2016 "Për shfuqëzimin e udhëzimit nr. 3, datë 27.11.2013, të Këshillit të Ministrave "Për pezullimin e përkohshëm të udhëzimit nr.1, datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara" me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë ,

**VENDOSI:**

7. Të miratojë listën e siperfaqes së tokës bujqësore prej **48,8290** Ha ( Dyzet e tetemije e tetemije e dyqind e nentedhjete ha),të ndodhur në Njësitë Administrative Proptisht, Çërravë, Velçan, Buçimas që mund të jepen me qera sipas listës.

| Nr | Pronësia | Zona Kadastrale | Numëri Pasurisë | Vëndodhja Fshati | Lloji Pasurisë | Sipërfaqja në m2 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Shtet | 1903 | 169/5 | Guras Buçimas | PF | 124600 |
| 2 | Shtet | 3304 | 265/1 | Senisht Velçan | Arë | 31400 |
| 3 | Shtet | 3304 | 265/2 | Senisht, Velçan | Arë | 2500 |
| 6 | Shtet | 3188 | 172/49 | Rr Poshte, Proptisht | Arë | 25838 |
| 7 | Shtet | 3188 | 172/26 | Rr Poshte, Proptisht | Arë | 3350 |
| 8 | Shtet | 2006 | 72 | Jollë, Velçan | Arë | 4696 |
| 9 | Shtet | 3745 | 364 | Verdove, Buçimas | Arë | 8450 |
| 10 | Shtet | 3167 | 723/9 | Rëmenj, Buçimas | PF | 10000 |
| 11 | Shtet | 3167 | 427 | Rëmenj, Buçimas | Arë | 1970 |
| 12 | Shtet | 3167 | 399 | Rëmenj, Buçimas | Arë | 2590 |
| 13 | Shtet | 3728 | 347/2 | Velçan, Velçan | Arë | 4175 |
| 14 | Shtet | 3304 | 143/7 | Senisht, Velçan | Arë | 20081 |
| 15 | Shtet | 3304 | 143/3 | Senisht, Velçan | Arë | 2040 |
| 16 | Shtet | 1832 | 4 | Grabovicë, Cërravë | Arë | 246600 |
| Σ | **TOTALI** | | | | | **488290** |

8. Toka Bujqësore që do të jepet me qera do te shfrytëzohet vetëm për veprimtari bujqësore dhe te tjera veprimtari ne funksion te saj.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA POGRADEC

Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: bashkiapogradec@gmail.com

9. Afati i dhënies me qera do të jetë në përputhje me destinacionin e kultivimit por asnjëherë më i gjatë se afati i përcaktuar pikën IV të Udhëzimit nr. 1, datë:18.07.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e dhënies me qera të tokave bujqësore të pandara".
10. Çmimi dysheme i vlerës së qerasë nuk do te jete jo më pak se 6000 (gjashtëmije) lekë Ha në vit sipas pikës nr 10 të Udhëzimit nr. 1, datë:18.07.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e dhënies me qera të tokave bujqësore të pandara".
11. Per zbatimin e vendimit ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Burimeve Njerezore dhe Çështjeve Juridike, si dhe Njësitë Administrative Proptisht, Çërravë, Velçan, Buçimas.
12. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.

**KRYETAR I KËSHILLIT**

**Sotiraq MANGËRI**

REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA POGRADEC

Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: bashkiapogradec@gmail.com